

VENDIM
Nr.31, datë 14.7.1998

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli	Anëtar i ""
Hajredin Fuga	Anëtar i ""
Zija Vuci	Anëtar i ""
Kristofor Peçi	Anëtar i ""
Alfred Karamuço	Anëtar i ""
Kujtim Puto	Anëtar i ""
Sokol Sadushi	Anëtar i ""
Franc Jakova	Anëtar i ""

me sekretare Arta Palushi, më datë 10.6.1998 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.23 Akti, që i përket:

Kërkues: Gjykata e Rrethit të Vlorës

OBJEKTI: Papajtueshmëria e neneve 141 dhe 327/2 të Kodit të Procedurës Penale me nenin 8 të ligjit nr.7692, datë 31.3.1993 "Për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut".

Gjykata Kushtetuese: pasi dëgjoi relacionin përkatës dhe e shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Gjykata e Rrethit - Vlorë ka pezulluar gjykimin në mungesë të dy të pandehurve për vrasje me paramendim dhe ka kërkuar nga Gjykata Kushtetuese të deklarojë papajtueshmërinë e neneve 141 dhe 327/2 të Kodit të Procedurës Penale me nenin 8 të ligjit "Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut".

Ndonëse gjykata në kërkesë është shprehur për papajtueshmërinë e neneve 141 dhe 327/2 të Kodit të Procedurës Penale me nenin 8 të Ligjit Kushtetues, me përmbajtjen e kërkesës, ajo në tërësi procesin e hetimit dhe gjykimin në mungesë të të pandehurve e konsideron antikushtetues.

Pas një shqyrtimi të hollësishëm të të gjitha normave procedurale të hetimit dhe gjykimin të personave të akuzuar për vepra penale (qofshin ata edhe në mungesë), Gjykata Kushtetuese nuk konstaton norma procedurale penale që vijnë ndesh me nenin 8 të ligjit Kushtetues. Në të kundërt, ndryshe nga Kodi i mëparshëm i Procedurës Penale, në Kodin e Ri të Procedurës Penale, i cili ka hyrë në fuqi më 1 gusht 1995, janë bërë një sërë ndryshimesh në drejtim të demokratizimit të procesit të hetimit dhe gjykimin të çështjeve penale dhe zgjerimit e garantimit të të drejtave të të pandehurve në procesin penal në përputhje me aktet që mbrojnë e garantojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si në ligjin tonë kushtetues, ashtu edhe në aktet e konventat ndërkombëtare.

Sipas procedurës së re i pandehuri pyet vetëm pasi të japë pëlqimin (neni 166). Po ashtu, parashikohet e drejta e të pandehurit të mos marrë pjesë në shqyrtimin gjyqësor, e deri e drejta e tij të largohet në çdo kohë nga salla e gjyqit (neni 352).

Gjithashtu, ndryshe nga Kodi i vjetër i Procedurës Penale, sipas të cilit me mosgjetjen e të pandehurit vendosej pezullimi i çështjes penale, sipas rregullave të reja procedurale lejohet hetimi dhe gjykimi i të pandehurit në mungesë të tij.

Garancitë procedurale penale që parashikon neni 8 i ligjit kushtetues - vënia në dijeni për akuzën, e drejta për t'i bërë pyetje dëshmitarëve dhe për të kërkuar paraqitjen e dëshmitarëve, të ekspertëve dhe personave të tjerë - mund të realizohen si nga i pandehuri, ashtu edhe nga mbrojtësi i tij. Ky i fundit ka të drejtat që ligji i njeh të pandehurit (neni 50). Caktimi i mbrojtësit për të pandehurin e pagjetur bëhet nga autoriteti procedues jo në mënyrë të pakushtëzuar, por vetëm pasi ky organ t'i ketë konsumuar të gjitha obligimet që i ngarkon ligji për gjetjen e të pandehurit, siç janë njoftimi në banesë, në vendin e punës, në vendbanimin e përkohshëm, afishimi i njoftimit në portën e shtëpisë ose të vendit ku punon (neni 140) dhe kërkimi i të pandehurit dhe nxjerrja e vendimit të mosgjetjes (neni 141).

Në mbrojtje të të drejtave të të pandehurit si në prani, ashtu edhe në mungesë të tij, prokurori, gjyqtari dhe mbrojtësi kanë një seri detyrimesh ligjore. Kështu, prokurori ka për detyrë të hetojë personalitetin e të pandehurit (neni 42), përgjegjshmërinë e tij (neni 43), të njoftojë mbrojtësin për

caktimin e ekspertit dhe t'i japë të drejtën të parashtrojë pyetje e të marrë pjesë në ekspertim (neni 179), t'i caktojë të pandehurit mbrojtës kryesisht (neni 309), t'i kryejë kontrollimet dhe sekuestrimet në prani të mbrojtësit (neni 310). Detyrën e caktimit të mbrojtësit kryesisht e ka edhe gjykata (neni 348/2), si dhe pyetjen e dëshmitarëve në shtëpi ta zhvillojë në prani të mbrojtësit (neni 364). Ndërsa mbrojtësit e caktuar kryesisht nga lista e avokatëve të vënë në dispozicion nga këshilli drejtues i Dhomës së Avokatëve (neni 49/3), përveç të drejtave që kanë për përjashtimin e ekspertëve (neni 180), kërkimin e provave të tjera (neni 336), pyetjen e ekspertëve (neni 337) etj., kanë edhe detyrën e besnikërisë dhe ndershmërisë (neni 56).

Gjykata e gjen të pabazuar dyshimin që shpreh pala kërkuese për mbrojtësin e caktuar nga organi procedues ("shteti si palë kundërshtare në procesin penal", siç shprehet ajo). Avokati qoftë si detyrim ligjor, qoftë për shkak të etikës profesionale e ka për detyrë të përdorë me ndërgjegje të plotë të gjitha kompetencat që i njeh ligji dhe aftësitë e tij personale për rmbrojtjen e të pandehurit, njëllon si në rastin kur zgjidhet prej vetë të pandehurit, ashtu edhe kur caktohet nga organi procedues.

Hetimi dhe gjykimi në mungesë i personave që kanë kryer vepra penale, bëhet vetëm pasi t'u jetë caktuar mbrojtës dhe ka për qëllim realizimin e detyrës madhore që kanë organet e drejtësisë në fushën penale - ndëshkimin e krimit dhe të autorit të tij.

Së fundi, për të siguruar e realizuar dhënien e drejtësisë, ligji procedural parashikon edhe institutin e rishikimeve të vendimeve që kanë marrë formë të prerë (neni 450), garanci tjetër kjo edhe për personat e gjykuar në mungesë.

PËR KËTO ARSYE,

duke u bazuar në nenet 24 e vijues të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", Gjykata Kushtetuese unanimisht,

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.